

KESHILLA PRINDERVE**PAS VAKSINIMIT BCG****Vaksinë BCG = vaksinë kundër tuberkulozit**

Fëmija juaj sapo është vaksinuar me vaksinën BCG, **me injektim nën lëkurë**. Këtu më poshtë do të gjeni **pasojat e ndryshme, normale** të lidhura me këtë vaksinë.

Informacione të përgjithshme :

Kjo vaksinë **nuk jep temperaturë** në ditët pas vaksinimit dhe nuk nevojit asnjë mjekim. Në rast rritje temperature, këshillohuni me mjekun kurues (e familjes).

Një dozë e vetme e vaksinës është e mjaftueshme për gjithë jetën.

Vaksina do të fillojë efektin e saj brënda 2 ose 3 javësh dhe do të mbërrijë në maksimumin e saj pas 2 ose 3 muajsh, që është kohëzgjatja mesatare e veprimit pas kryerjes së vaksinës.

Situata të mundshme në pikën e injektimit:

- Asnjë reagim në vendin e injektimit : asgjë për të bërë në këtë rast.
- **Pas dy ose tre javësh**, në vendin e vaksinimit mund të shfaqet një skuqje e vogël (puçërr e vogël, e kuqe e ngjashme me pickimin e mushkonjës). Ka dy zhvillime :
 - ✓ Puçërra mbetet në fazën e **puçërrës** : asgjë për të bërë në këtë rast.
 - ✓ Puçërra mund të marrë një pamje të fryrë, me flluska që i ngjan një abscesi, **por nuk është absces**. Mbi të gjitha **nuk duhet t'a prekni dhe prisni që lëngu të dalë vetë**. Kjo puçërr mund të djersisë dhe të prodhojë në disa raste **një lëng rrjedhës me ngjyrë të verdhë**, jo i qelbëzuar, përgjatë 3 deri në 8 javë. Në këtë rast është e rekomandueshme **t'a pastroni me ujë dhe me sapun**, të paktën një herë në ditë deri në përtharjen e saj.

Të gjitha këto reagime janë normale dhe nuk duhet t'ju shqetësojnë. Ato shërohen vetë duke lënë një shënjë të vogël rozë që shndërohet më tej në një shënjë vaksine.

KESHILLA NE RAST TE NJE RRJEDHJE TE ZGJATUR

- Mos u mundoni t'a përthani me pudra apo me pomada dizinfektuese dhe përtharëse.
- Vendosni një kompresë të vogël sterile të thatë dhe fiksojeni atë me një shirit garze për të evituar fërkimin me veshjet. Evitoni t'i vini leukoplast i cili mund të krijojë reaksione alergjike lokale.
- Në sezonin e verës ekspozojeni krahun në diell.
- Në rast qëndrimi të zgjatur në ujë, vendosni një fasho që i reziston ujit.
- Shmangni veshjen e rrobave shumë të ngushta për të kufizuar fërkimet.

Për çdo sqarim në lidhje me pasojat e kësaj vaksine, mund të më kontaktoni në

Dr. Geneviève GRAVIL-BAILLON

Mjeke Kordinatore

CLAT 74 SUD

Tel : 04 50 63 64 89

Fax : 04 50 63 64 90

Mail : clat74sud@ch-annecygenevois.fr

Centre Hospitalier Annecy Genevois

1 avenue de l'hôpital

74370 Epagny Metz-Tessy

www.ch-annecygenevois.fr